



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2022:001072

Datë: 15.02.2022

Numri i dokumentit: 02713710

CPP.nr.1/22

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRI-Departamenti i Pergjithshem-Divizioni Civil, si permbarimore e perbere nga Gjykatesi Individual Besnik Feka, ne çështjen juridike te kreditorit P. N. nga Fushe Kosova, te cilin me autorizim e përfaqëson av. Apolona Sylja me seli ne Prishtine, kundër debitorit “E.SH.P.K me seli ne Vushtrri per shkak te borgjit ne shume prej **3,750 euro**, gjykata duke vendosur sipas prapësimit te debitorit ushtruar kundër Urdherit per Lejimin e Permbarimit, jashtë seancës me dt: **15.02.2022**, nxjerr kete:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET I PABAZUAR prapësimi i debitorit “E.” SH.P.K me seli ne Vushtrri, ashtu qe: **VERTETOHET** Urdheri per Lejimin e Permbarimit i Permbaruesit Privat **P.nr.689/21, dt: 15.12.2021.**

A r s y e t i m

Kreditori, P. N. me banim ne Fushe Kosove, përmes te autorizuarës se tij av. Apolona Sylja me seli ne Prishtine, ka ushtruar propozim per lejimin e permbarimit te kontratës se pune te noterizuar sipas numrit |LRP.nr. Ref:366/1777/2020, te dt: 03.06.2020, përkatësisht nenit 5 dhe 21 te kontratës ne fjale, ku eshte përcaktuar se poqese punëmarrësi realizon shitjen mbi 15% atëherë i takon bonusi ne vlere prej 7,500 euro, ndersa ne nenin 21 eshte përcaktuar me vullnetin e palëve qe kontrata ne fjale, ne rastet e mos zbatimit te saj eshte objekt i permbarimit drejteperdrejt te permbaruesi privat ne procedurën e permbarimit.

Permbaruesi Privat me Urdherin per Lejimin e Permbarimit P.nr.689/21, dt: 15.12.2021, ka lejuar permbarimin sipas faturave te prezentuara nga kreditori.

Debitori, “E.” SH.P.K me seli ne Vushtrri, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim, kundër Urdherit per Lejimin e Permbarimit, duke e kundërshtuar ne tërësi propozimin per permbarim dhe urdherin per lejimin e permbarimit, me arsyetimin se kreditori nuk ka realizuar dhe repsektuar kontratës ne tërësi, pasiqe, ka japë dorëheqje para skadimit te saj dhe nuk ka kryer punën siç duhet duke iu referuar performances se dobët si drejtor i shitjeve ne terren. Mbi bazën e te gjitha këtyre arsyeve, ka propozuar gjykatës qe te aprovoj prapësimin e debitorit dhe anuloj Urdherin per Lejimin e Permbarimit dhe propozimin per permbarim ta refuzoj te pabazuar.

Kreditori, përmes te autorizuarës se tij av. Apolona Sylja, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim, duke e kundërshtuar ne tërësi pretendimet e parashtruara nga debitori ne prapësim, duke i propozuar gjykatës qe prapësimin e debitorit ta refuzoj te pabazuar.

Gjykata, pas shqyrtimit te prapësimin te debitorit, përgjigjes ne prapësim te kreditorit provave qe gjenden ne shkresat e lendes, gjeti se prapësimi i debitori eshte i pabazuar per arsyet si ne vijim:

Kreditori dhe debitori sipas kontratës së noterizuar me numër LRP.nr.Ref:366/1777/2020, dt: 03.06.2020, janë pajtuar që kreditori të themelojë marrëdhënie pune për kohë të caktuar në pozitën “Drejtor i Shitjes” për periudhën kohore 15.06.2020, e gjer me 31.12.2020. Me nenin 5 të kësaj kontrate janë përcaktuar bonuset që do të realizoj punëmarrësi-kreditori me rastin e realizimit të planit dhe targetit të shitjeve dhe atë sipas lartësisë së përqindjes së tejkaluar, ku në pikën pasuesin II të këtij neni është përcaktuar se nëse për debitorin-punedhensin realizohen shitjet mbi 15% me shume të vitin e kaluar të punësuarit-kreditorit i takon bonusi prej 7,500 euro.

Në nenin 21 të kësaj kontrate palët kontraktuese kreditori si punëmarrës dhe debitori si punëdhënës, janë pajtuar që kontrata e punës si dokument noterial i dakorduar dhe lidhur mes tyre të përmbajë edhe vërtetimin mbi përmbarueshmërinë, e që është përcaktuar se dispozitat e kësaj kontrate në rast të moszbatimit nga palët ndergjyqese do të jenë drejteperdrejte objekt i ekzekutimit përmes përmbaruesit privat në procedurën e përmbarimit. Këtu fakti noteriali ka paralajmëruar palëve kontraktuese që kanë rënë dakord për ekzekutimin pa vonesë dhe iu ka shpjeguar pasoja ligjore të një deklaramenti të tillë, ku me vënien e neshkrimeve të tyre, palët kontraktuese janë konsiderohet se i kanë kuptuar në tërësi.

Nga të dhënat e dorëzuara nga kreditori për periudhën kohore 01.06.2020 e gjer me 21.12.2020, lidhur me listat e produkteve dhe krahasimin e shitjeve për vitet 2019 dhe 2020, rezultojnë se produktet e listuara në indeksin e rritjes së shitjes së këtyre produkteve ka pësuar rritje në vlerat e përcaktuara në listë, ku totali i përqindjes së tejkaluar të shitjeve nga kreditori si drejtor i shitjes për periudhën e lartecukur kontraktuese arrijnë në përqindjen totale prej 15.33 %, dhe nga kjo rezultojnë se kreditori ka realizuar kontratën e punës, gjegjësisht nenin 5 të saj, ku është përcaktuar detyrimi i debitorit në kompensimin e shumës në emër të bonusit për tejkalimin e planit dhe targetit të shitjes nga kreditori si punëmarrës.

Me nenin 22, par.1, nenpar.1.3 të Ligjit për Procedurë Përmbarimore nr. 04/L-139, përcaktohet si dokument përmbarimor rasti i përmbarueshmërisë së dokumenteve noteriale citoj “ **dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë**”, ndërsa me nenin 43, par.4 të Ligjit për Noterine nr. 06/L-010, përcaktohet se kur konsiderohet një dokument noterial me fuqi përmbaruese citoj “ **Dokumenti noterial është dokument përmbarimor në qoftë se është përpiluar në formën e paraparë dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm**”, ndërsa me par.4 të këtij neni përcaktohet “ **Në rastet kur dokumenti noterial është dokument përmbarimor sipas këtij neni, noteri me kërkesën e palës, vet e vënë në dokument vërtetimin për përmbarueshmërinë**”.

Gjykata, nisur nga provat dhe gjendja e vërtetuar me lartë, gjen se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për faktin se kreditori si punëmarrës ka realizuar kontratën dhe nenin 5 të saj duke tejkaluar normën e shitjes mbi 15% të shitjes së produkteve si Drejtor i Shitjes të debitorit për vitin periudhën kohore të vitit 2020 dhe atë dt: 01.06.2020 e gjer me 21.12.2020, në krahasim me shitjen e të njëjtave produkte nga viti i kaluar 2019, andaj, mbi këto baze kreditori i takon kompensimi dhe përmbushja e detyrimit në vlerën e kërkuar sipas propozimit për përmbarim në shume prej 3,750, që ka kërkuar e që rezultojnë të jete shuma prej ½ e lartësisë së përcaktuar me kontratë prej 7,500 euro për shitjet e realizuara mbi 15% të tyre sipas planit dhe targetit të shitjes së produkteve, nga kjo baze, derivon e drejta e kreditorit dhe detyrimi i debitorit në përmbushjen e kompensimit ngase gjen mbështetje në nenin 8 dhe 245 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin theksohet citoj “ **Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë të përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit**”, po ashtu në nenin 245, par.1 të të njëjtit ligj parashihet citoj “ **Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij, Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve ose në bazë të ligjit**”.

Gjithashtu, me nenin 130 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 është përcaktuar “ **Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese**”,

Gjykata, me rastin e vendosjes, pati parasysh edhe pretendimet-kundershtimet e debitorit se kreditori nuk ka përmbushur kontratën dhe nuk ka respektuar kontratën e punës si dhe pretendime tjera, mirëpo, të njëjtat i refuzoi të pabazuara, ngase për pjesën ku kërkohet përmbarimi nga kreditori vërtetohet se kontrata nga ana e kreditorit është përmbushur sipas dakordimeve të tyre, ndërsa për pjesën tjera, kjo gjykate vlerëson se nuk mund të jenë objekt

Numri i lëndës: 2022:001072
Datë: 15.02.2022
Numri i dokumentit: 02713710

i shqyrtimit ne kete procedure përderisa nuk ka kompetence te lëshohet me tutje ne zbatimin apo mos zbatimin e kontratës ne fjale pa kerkese eventuale ne procedure përkatëse nga palët ndergjyqese, ashtu qe, te njëjtat pretendime i refuzoi te pabazuara. Duke shtuar edhe faktin se edhe debitori per mosrealizim eventual te kontratës se punes ka te drejtat e njëjta sikurse kreditori nga kontrata e noterizuar dhe e aplikuar me vërtetimin per permbarueshmerine e dispozitave te kësaj kontrate, atëherë, gjykata nuk ka tagër qe sipas kërkesës se kreditorit te lëshohet edhe ne domenin e mospermbushjeve tjera nga palët, porse vetëm brenda kërkesave te tyre.

Prandaj, mbi bazën e te gjitha arsyeve te cekura me larte, gjykata, bazuar ne nenin 43, par.4, ne lidhje me nenin 71 dhe 73 te LPP-se, gjeti se prapësimi i debitorit eshte pjesërisht i bazuar, mbi bazën e arsyeve te dhëna me larte.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI
Departamenti i Pergjithshem-Divizioni Civil
CPP. nr.1/22, dt: 15.02.2022

GJYKATESI
Besnik Feka

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kunder ketij aktvendimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditesh, nga dita e pranimit te ketij aktvendimi, Gjykates se Apelit ne Prishtine. Ankesa ushtrohet permes kesaj gjykate.